



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SONILA A. XUKTHI  
ADRESA NR.5, EMIN DURAKU,  
NR.52, NR.1, NR.4  
TEL:

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1343

Nr. koleksioni: 601

Tirane më 04/09/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 12 fletë



A2020052700057966925





A2020052700057966925

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**  
( TË SHOQËRISË "OPEN TECH Consulting& services" SH.P.K)

Sot, më datë 04/09/2020, para meje Notere SONILA A. XUKTHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, EMIN DURAKU, NR.52, NR.1, NR.4, u paraqit personalisht:

**SHITES:**

Ermal Luçi, atësia Sami, amësia Afërdita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, Tiranë, Shqipëri (ALB) dhe banues në TIRANË, me adresë rruga Ali Demi pallati 74 , shk 8 ap.97 ; TIRANË, lindur më 02/12/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031706091 dhe nr. personal I01202088I, me cilesine e ortakut te shoqerise "Open Tech Consulting &services"sh.p.k.

**BLERES:**

Shoqëria OpenTech consulting & Services, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L41329019U, ; me seli në Fusha QytetPale, me adresë Rruga Vllazen Huta, Nd.8, Kati 7, Ap.7C, përfaqësuar nga Administratori Ermal Xhaferri, atësia Dylber, amësia Nazime, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan, Shqipëri (ALB) dhe banues në Tiranë, me adresë Njesia Nr.4 Rr.Njazi Meka; Nd. 028; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 04/03/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034230937 dhe nr. personal I40304051P.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "OPEN TECH Consulting& services" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**BAZA LIGJORE**

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;  
Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";  
Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

A. Meqenese egzistojne keto kushte paraprake ;

**Shoqeria "OPEN TECH Consulting& services " sh.p.k** ,eshte regjistruar ne QKB me Nr Nipti : L41329019U,me seli "Rruga Vllazen Huta"TIRANE, me ortake themelues Z.Ermal Xhaferri dhe Ermal Luci , vlere e kapitalit te shoqerise referuar historikut te regjistrimit eshte **10.000,00 lek** , **numri i pergjithshem i kuotave 2,00** ,zoteruar nga dy ortaket e shoqerise ne raportet si me poshte ;

**Z.Ermal Xhaferri** zoteron 1 kuote ne vlere kapitali ne natyre 8.000,00 lek qe perfaqson pjesmarrije ne perqindje 80 % te kapitalit te shoqersise.

**Z.Ermal Luci** zoteron 1 kuote ne vlere kapitali ne natyre 2.000,00 lek qe perfaqson pjesmarrije ne perqindje 20 % te kapitalit te shoqersise.

B-Ne vendimin nr .2 dt .04.09.2020 , asambleja e ortakeve te shoqerise ka miratuar **shitjen e**





nje kuote te zoteruar nga pala shitese Z.Ermal Luci ne favore te pales blerese Z.Ermal Xhaferri dhe konkretisht .

Pala shitese i shet pales blerese 1 kuote qe perfaqson pjesmarrjen ne perqindje 20% te kapitalit te shoqerise "Open Tech Consulting&services"sh.p.k.

## Neni 2

### Çmimi i Shitjes dhe menyra e likuidimit

Çmimi i plotë i shitjes së kuotave është 2.000 leke (dymije leke) .

~~Z. Ermal Luci ka rënë dakortë ti shesi pales blerese nëpërmjet shitblerjes 1-kuot qe perfaqson 20% te kapitalit te shoqerise, kundrejte cmimit 2000 leke(dy mije lek) shume e cila eshte likuiduar nga pala blerese ne favore te pales shitese kesh ne dore jashte zyres se noteris.~~

## Neni 3

### Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

4.1 Kontrata do te regjistrohet ne QKB qysh ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate ndersa Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësi do të kryhet menjeher.

## Neni 4

### Garancitë

Shitësi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton Blerësin:

6.1. Se është pronar i vetem i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.

6.2. Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.

6.3. Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.

6.4. Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes se Kontratës së Shitblerjes se Kuotave , veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

6.5 Pala shitese me nenshkrimin e kesaj kontrate ,heq dore perfundimisht nga pronesia mbi kuotat qe shet , te gjitha te drejtat dhe detyrimet i kalojne pales blerese

**Pas ketij veprimi, shoqeria do te kete 1(nje) kuot e cila do te zoterohet nga ortakui vetem i shoqerise Z. Ermal Xhaferri ne masen 100%.**

## Neni 6

### Regjistrimi

7.1. Regjistrimi i kontrates per kalimin e kuotave nga Shitësi te Blerësi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

## Neni 8

### Ligji i zbatueshëm

8.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

## Neni 9

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve





9.1. Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

**Neni 10**  
**Të ndryshme**

10.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.

10.2 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve duke respektuar formën shkresore të noterizuar.

**ANEKSET E KONTRATËS**

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 2, datë 04.09.2020,
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë.
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËTKONTRAKTUESE**

**SHITES**

Ermal Luçi me cilesine e ortakut te shoqerise "Open tech Consulting&services" sh.p.k

*Ermal Luçi*

**BLERES**

Ermal Xhaferri me cilesine e ortakut te shoqerise Shoqeria "Open Tech Consulting &services sh.p.k

*Ermal Xhaferri*



NOTERË  
*Burim Kulla*  
*Noteri*



Nr.002.Prot.

Tirane,me 04.09.2020

Nr. Kopjeve 1 nga 4

**VENDIM datë 04/09/2020**

**Nr.2**

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE**

**TË SHOQËRISË**

**OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK**


Sot më datë 04/09/2020, u mbledh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë **"OpenTech Consulting & Services" SHPK** në prezencë të të gjithë ortakëve të saj, konkretisht Z.Ermal Xhaferri i cili zotëron 1(një) kuotë që përfaqëson 80% të kapitalit të shoqërisë dhe Z.Ermal Luçi i cili zotëron 1(një) kuote që përfaqëson 20% të kapitalit të shoqërisë, për të diskutuar, shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me rendin e ditës si me poshtë:

- Transferimi nëpërmjet shitjes së 1(një) kuote që përfaqëson 20% të kapitalit të shoqërisë që ortaku **Z.Ermal Luçi** zotëron në shoqëri, në favor të ortakut **Z.Ermal Xhaferri**, atësia **Dylber**, i datëlindjes 04.03.1984, lindur në Elbasan dhe banues në Rr.Njazi Meka.P.5,Shk.2,Ap.25,Allias,Tiranë,shtetas Shqiptar,madhor,me zotësinë e plotë për të vepruar,mbajtës i letërnjoftimit nr.personal I40304051P,kundrejt çmimit të shitjes **LEK 2.000**(Dy mijë lekë)
- Të tjera

Pas një diskutimi të hollësishëm të pikave të mësipërme,të përfshira në rendin e ditës,asambleja e përgjithshme e ortakëve,në mënyrë unanime vendosi:

**VENDOSI**

- Te miratoje transferimi nëpërmjet shitjes së 1(një) kuote që përfaqëson 20% të kapitalit të shoqërisë që ortaku **Z.Ermal Luçi** zotëron në shoqëri, në favor të ortakut **Z.Ermal Xhaferri**, atësia **Dylber**, i datëlindjes 04.03.1984, lindur në Elbasan dhe banues në Rr.Njazi Meka.P.5,Shk.2,Ap.25,Allias,Tiranë,shtetas Shqiptar,madhor,me zotësinë e plotë për të vepruar,mbajtës i letërnjoftimit nr.personal I40304051P,kundrejt çmimit të shitjes **LEK 2.000**(Dy mijë lekë)



- Ngarkohet **Znj.Glediona Blea** mbajtëse e letërnjoftimit nr.J65611051D për depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit si dhe kryerjen e çdo lloj veprimi pa kufizim për arritjen e qëllimit të mësipërm.

**Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë ortakët e pranishëm te Shoqërisë dhe hyn në fuqi menjëherë.**

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Përfaqësuar nga

**Ermal XHAFERRI**



**Ermal LUÇI**

